

VENDIM
Nr. 947, datë 28.12.2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.599, DATË 23.7.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E PAGESAVE QË KRYHEN NË AKEP, PËR CAKTIMIN DHE PËRDORIMIN E FREKUENCAVE, TË NUMRAVE DHE TË SERIVE NUMERIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 119, pika 2, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në lidhjen nr. 1, të vendimit nr. 599, datë 23.7.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 2.1, “Shërbimi publik i lëvizshëm tokësor”, fjalët “...Pagesat vjetore për përdorimin e frekuencave radio për shërbimin telefonik publik të lëvizshëm tokësor (GSM, UMTS 900/1800 MHz dhe UMTS (1900-1980) dhe (2010-2170) MHz, do të llogariten sipas të dhënave të tabelës nr.1...” zëvendësohen me “...Pagesat vjetore për përdorimin e frekuencave radio për sistemet e lëvizshme tokësore (GSM, UMTS / LTE/ WiMAX) dhe për rrjetet e komunikimit fiks/i lëvizshëm, përfshirë ata IMT, do të llogariten sipas të dhënave të tabelës nr.1...”.

2. Në fund të pikës 2.6, pas tabelës 9 shtohet shënimi: “Shënim: Pagesa sipas pikës 2.5, e tabelës 9, nuk aplikohet për licencat/lejet e përkohshme, deri në tre muaj, të radioamatorëve të huaj që zotërojnë licenca të tipit CEPT.”.

3. Në tabelën 10, të pikës 3, fjalët “...Shërbimi paging (63)...”, zëvendësohen me “...Shërbimi paging...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama